



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 6 prot.

Kamëz, më 22.01. 2024

V E N D I M

Nr 06 Datë 22 / 01 / 2024

M B I

“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR TRAJTIMIN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA BUXHETI I BASHKISË KAMËZ PËR VITIN 2024”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.01.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.03 Datë 11.01.2024 në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 21 të Ligjit nr. nr.57 datë 18/07/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë, kreut IV, të Vendimit nr. 597 datë 04/09/2019 “për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr.103 dt.18.12.2023 “Mbi miratimin e Projekt - Buxhetit afat-mesëm të Bashkisë Kamëz (PBA)”, për vitin 2024, 2025, 2026, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve në nevojë nga fondet e buxhetit lokal, si më poshtë vijon;
 - a. Familje me fëmijë jetim.
 - b. Familje që jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme.
 - c. Të moshuar që janë të vetmuar.
 - d. Familje me persona invalid dhe kushte shumë të vështira ekonomike dhe sociale pa të ardhura të tjera.
 - e. Familje me kryefamiljarë në burg dhe fëmijë të vegjël.
 - f. Familje me probleme dhune në familje apo viktime të mundshme trafikimi.
 - g. Familje që kanë probleme të mëdha shëndetësore dhe kërkojnë ndërhyrje të rënda kirurgjikale etj.
 - h. Familje që kanë fatkeqësi njerëzore dhe familjet e prekura nga fatkeqësitë natyrore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Familjet e sipërcituara do të verifikohen për situatën ekonomike nga administratorët shoqëror të ndihmës ekonomike dhe masa e përfitimit do jetë bazuar në vlerësimin e vështirësisë ekonomike, shëndetësore dhe sociale, numrit të anëtarëve në familje, bazuar gjithashtu në fondin e vënë në dispozicion.

Kohëzgjatja e qendrimit në skemë do të jetë e limituar në kohë dhe e kushtëzuar me vlerësimin social-ekonomik për ndryshimin e kushteve të jetesës.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

